



RAPORT VJETOR

2025

AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Tiranë, 2026



PËRMBAJTJA

I. Objektivat për vitin 2025	1
Aktivitetet e realizuara	1
II. Problematikat e evidentuara.....	8
III. Objektivat për vitin 2026	10

I. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2025

Objektivi i përgjithshëm

Projektimi, ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i një sistemi gjeohapësinor funksional e të integruar (NSDI), i cili prodhon informacion dhe njohuri gjeohapësinore, në përputhje me standardet e BE-së/INSPIRE.

Objektivat specifikë për vitin 2025

1. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i Kornizës Referuese Gjeodezike, me saktësi të lartë dhe të unifikuar me sistemin evropian, në funksion të realizimit të punimeve gjeodezike dhe hartografike sipas standardeve bashkëkohore.
2. Krijimi i GIS-it Kombëtar dhe funksionimi i Gjeoportalit Kombëtar për të ofruar informacion gjeohapësinor të përditësuar dhe të standardizuar, në funksion të vendimmarrjeve të drejta për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. Mbarëvajtja e projektit “Shërbime Satelitore” në kuadër të Monitorimit të Territorit me Teknologji të Avancuar, si dhe përpunimi i të dhënave Remote Sensing.
4. Harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore ekzistuese dhe krijimi i të dhënave të reja për temat e gjeoinformacionit, veçanërisht i Hartës Bazë, në përputhje me standardet e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Forcimi i koordinimit të brendshëm dhe ndërinstitucional, hartimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor e rregullator në fushën e gjeoinformacionit, menaxhimi i projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ngritja e kapaciteteve nëpërmjet programeve të trajnimit.
6. Sigurimi dhe menaxhimi i burimeve financiare nga buxheti i shtetit dhe financimet e huaja, për të garantuar inputet e nevojshme për realizimin e objektivave të ASIG-it, si dhe menaxhimi i burimeve njerëzore dhe i shërbimeve mbështetëse për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të institucionit dhe realizimin e objektivave teknike të tij.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Për përmbushjen e objektivave të përcaktuar për vitin 2025, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Është garantuar funksionimi i pandërprerë i Gjeoportalit Kombëtar, pavarësisht përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes në muajin tetor 2024. Monitorimi, kontrolli dhe mirëmbajtja e sistemit janë realizuar nga stafi teknik i ASIG-it, në zbatim të urdhrit nr. 53, datë 16.02.2023, “Për administrimin e Gjeoportalit Kombëtar”. Janë realizuar periodikisht proceset e krijimit të kopjeve rezervë (backup) dhe rikthimit të sistemit (restore), si dhe është përgatitur dokumentacioni përkatës. Gjithashtu, është garantuar administrimi teknik dhe funksionimi i faqeve zyrtare www.asig.gov.al, www.geoportal.asig.gov.al dhe www.krgjsh.asig.gov.al, si dhe është ndjekur kontrata për mirëmbajtjen e softuerëve inxhinierikë dhe GIS.
- Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), janë rishikuar specifikimet teknike të projektit “Ndërtimi i Sistemit të GIS-it Kombëtar”, pasi vlera e përlogarit e projektit rezultoi më e lartë se buxheti i alokuar. Versioni i rishikuar i

specifikimeve teknike është dërguar më datë 19.09.2025, për vijimin e procedurave të prokurimit nga AKSHI.

- Në bashkëpunim me Autoritetet Publike Përgjegjëse, ka vijuar administrimi, kontrolli, përditësimi, harmonizimi dhe publikimi në Gjeoportalin Kombëtar i të dhënave gjeohapësinore sipas standardeve shtetërore, për temat:
 - “Korniza Referuese Gjeodezike”, me të dhënat për Rrjetin Shtetëror të Nivelimit, të përgatitura nga ASIG-u në kuadër të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare;
 - “Kufijtë e Njësive Administrative”, me të dhënat e Rendit IV për kufijtë e njësive administrative të Bashkisë Patos;
 - “Ortoimazheria”, me ortofotot UAV të viteve 2024–2025, ortofotot satelitore RGB dhe CIR të vitit 2025, të prodhuara nga përpunimi i të dhënave Remote Sensing, si dhe ortofotot historike të periudhës 1976–1986;
 - “Parcelat Kadastrale” dhe “Ndërtesat”, me të dhënat për zonat kadastrale, parcelat, ndërtesat, parcelat kadastrale ALBSCAD dhe ndërtesat kadastrale ALBSCAD, të përgatitura nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Qendra Kombëtare e Digjitalizimit;
 - “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”, me të dhënat për institucionet arsimore;
 - “Hidrografia”, me të dhënat e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore për lejet e dhëna nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Këshillat e Baseneve Ujore për veprimtari ndërtimore në brigje, shfrytëzimin e materialeve inerte, qëllime kurative dhe termale, akuakulturë, ujitje në bujqësi, ujë të ambalazhuar, industri dhe teknologji, hidroenergji, si dhe përdorime të tjera të ujit: ujë i pijshëm, sanitar dhe teknologjik;
 - “Zonat e Mbrojtura”, me të dhënat për zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore në format pikësor dhe poligonal, të përgatitura nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;
 - “Zonat me Rreziqe Natyrore”, me të dhënat për zjarret e vitit 2024, të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
 - “Rrjetet e Transportit”, me të dhënat për transportin rrugor dhe hekurudhor, të përgatitura nga ASIG-u.
- Si rezultat i publikimeve të realizuara, numri i përgjithshëm i shtresave të gjeoinformacionit të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar ka arritur në 431. Në platformë janë publikuar gjithashtu tetë vendime të Këshillit të Ministrave dhe një vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit.
- Në zbatim të kuadrit për të dhënat e hapura dhe të dhënat me vlerë të madhe, janë publikuar si të dhëna të parapërgatitura, nëpërmjet shërbimeve ATOM, gjithsej 130 shtresa gjeohapësinore, duke lehtësuar aksesin, ripërdorimin dhe analizën e të dhënave nga administrata publike, sektori privat dhe komuniteti akademik. Gjithashtu, është realizuar testimi i shërbimeve OGC API, në përputhje me standardet e Open Geospatial Consortium dhe kërkesat e Direktivës INSPIRE.
- Në kuadër të projektit buxhetor “Prodhimi i ortofotove nga fotografitë ajrore historike”, është publikuar në Gjeoportalin Kombëtar ortoimazheria e përftuar nga fotografimet ajrore të periudhës 1976–1986, e cila mbulon 16 qytete të Republikës së Shqipërisë dhe zonat përreth.

Gjithashtu, ka përfunduar procesi i marrjes në dorëzim të ortoimazherisë së prodhuar nga fotografitë ajrore të periudhës 1970–1986 për zonat kodrinore dhe malore të vendit.

- Kanë vijuar aktivitetet për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), në funksion të realizimit të referencës horizontale dhe vertikale moderne të vendit dhe unifikimit të saj me sistemet referuese evropiane dhe ndërkombëtare.
- Është realizuar për herë të parë llogaritja e gjeoidit gravimetrik shqiptar, duke u mbështetur në të dhënat gravimetrike, linjat e nivelimit dhe pikat e referencës klasike ALB89. Rezultatet paraprake kanë treguar një saktësi në intervalin 10–14 cm. Të dhënat dhe produktet e realizuara në kuadër të KRGJSH-së janë përgatitur dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar dhe në faqen zyrtare të ASIG-ut.
- Janë realizuar matjet gravimetrike relative të Rrjetit Gravimetrik të Rendit III, i përbërë nga 634 pika. Ka vijuar dendësimi i rrjetit, me synim arritjen e dendësisë $2 \text{ km} \times 2 \text{ km}$ në zonat fushore dhe $4 \text{ km} \times 4 \text{ km}$ në zonat malore, si dhe përmirësimin e saktësisë së llogaritjes së gjeoidit gravimetrik.
- Është realizuar ndërtimi dhe matja e nivelimit preciz të klasit I në linjat Durrës–Tiranë dhe Vorë–Shëngjin, me qëllim lidhjen e stacioneve mareografike të Durrësit dhe Shëngjinit, analizimin e ndryshimeve të nivelit të Detit Adriatik dhe vlerësimin e gjeoidit gravimetrik.
- Në funksion të krijimit dhe përditësimit të Hartës Bazë, është realizuar rilevimi fotogrametrik 3D për zonat urbane të Elbasanit, Ersekës, Burrelit, Pukës, Rubikut, Roskovecit, Maqellarës dhe Këlcyrës, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 27.4 km^2 , ndërsa 17.5 km^2 të tjera në Bulqizë, Këlcyrë dhe Rrëshen kanë qenë në proces rilevimi.
- Është realizuar rilevimi fotogrametrik edhe në zonat rurale të Shkodrës, përfshirë fshatrat Zogaj, Shullanë, Bërdicë, Obot, Barbullush, Rranxë, Prush dhe Shirq, të ekspozuara ndaj rrezikut të përmytjeve nga baseni Drin–Bunë. Gjithashtu, nëpërmjet moduleve fotogrametrike Trimble Inpho, është realizuar fototriangulacioni i fotografive ajrore të vitit 2024, të përfutuara nga projekti Trans Adriatic Pipeline (TAP).
- Ka vijuar përditësimi, strukturimi, simbolizimi dhe standardizimi i bazës së të dhënave topografike, mbështetur edhe në verifikimet në terren. Janë përgatitur dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar 250.9 km^2 të Hartës Bazë.
- Është realizuar monitorimi dhe verifikimi i vazhdueshëm i funksionimit të 27 stacioneve të Rrjetit Shtetëror Aktiv ALBCORS, si dhe menaxhimi i Qendrës së Monitorimit. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 49 përdorues të rinj të shërbimit RTK dhe janë administruar 24 kërkesa për të dhëna RINEX, ndërsa numri i përgjithshëm i përdoruesve të regjistruar ka arritur në 394.
- Ka vijuar mirëmbajtja teknike dhe fizike e stacioneve të rrjetit ALBCORS, me qëllim garantimin e shërbimit të qëndrueshëm 24/7, transmetimin e pandërprerë të të dhënave dhe adresimin në kohë të problematikave teknike.
- Janë realizuar matje periodike në pikat e rrjetit pasiv të Rendit I dhe II, në pikat ALB86 dhe me metodën RTK në zona të ndryshme të vendit. Gjithashtu, janë realizuar matjet për përcaktimin e datumit gjeodezik në 42 pika të Rendit I.

- Është realizuar monitorimi dhe asistenca teknike për funksionimin e katër stacioneve mareografike në Sarandë, Orikum, Durrës dhe Shëngjin, përfshirë kontrollin periodik, kalibrimin e sensorëve dhe monitorimin e transmetimit të të dhënave. Janë zhvilluar procedurat për sigurimin e pajisjeve të nevojshme për stacionet e Shëngjinit dhe Orikumit, si dhe janë përgatitur raportet periodike dhe analizat katërmujore për nivelin mesatar të detit.
- Ka vijuar zbatimi i marrëveshjeve për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet rrjetit ALBCORS dhe rrjeteve KOPOS të Kosovës dhe MAKPOS të Maqedonisë së Veriut. Janë hartuar gjithashtu specifikimet teknike për lidhjen e ALBCORS-it me rrjetet CORS të vendeve fqinje, në kuadër të procedurës “Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza V”.
- Projektet dhe produktet e KRGJSH-së janë prezantuar në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë workshop-in e Qendrës Globale Gjeodezike të Ekselencës së Kombeve të Bashkuara (UN-GGCE) në Bonn, prezantimin e gjeoidit dhe të Rrjetit Shtetëror Aktiv ALBCORS në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, si dhe Konferencën Ndërkombëtare IAG 2025 në Rimini. Gjeoidi shqiptar është publikuar në Shërbimin Ndërkombëtar për Gjeoidin (International Service for the Geoid – ISG), duke e bërë ASIG-un kontribues të drejtpërdrejtë në komunitetin gjeodezik ndërkombëtar.
- Ka vijuar zbatimi i projektit “Shërbime Satelitore” dhe mbledhja e imazheve satelitore me rezolucion 70 cm dhe 50 cm. Nga mundësitë e planifikuara për fotografimin satelitor gjatë vitit 2025, 63% janë realizuar dhe publikuar, 29% e imazheve janë refuzuar dhe 8% kanë qenë në proces. Nëpërmjet imazheve satelitore të përfutuara gjatë vitit 2025 është arritur mbulimi i 98% të territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Nga përpunimi i imazheve satelitore të viteve 2024 dhe 2025 janë prodhuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar ortofotot satelitore RGB dhe CIR. Produktet e vitit 2024 mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ndërsa ato të vitit 2025 mbulojnë rreth 96% të territorit. Gjithashtu, janë publikuar 21 imazhe satelitore LIB për qytetet Durrës, Tiranë dhe Vlorë, janë realizuar projektet për krijimin e hartave stereo dhe ka vijuar puna për prodhimin e Modeleve Digjitale të Terrenit dhe të Sipërfaqes.
- Është realizuar kontrolli dhe pranimi teknik i 231 dosjeve të imazherisë satelitore, përfshirë verifikimin e saktësisë së pozicionimit horizontal, plotësisë së produkteve dhe dokumentacionit shoqërues. Nëpërmjet platformës ArcGIS Online janë vendosur në dispozicion rreth 1 189 produkte satelitore për institucionet përgjegjëse në fushat e bujqësisë, mbrojtjes, mjedisit, pyjeve, ujërave, kontrollit të territorit dhe mbrojtjes civile.
- Janë realizuar 23 analiza dhe harta tematike për emergjencat civile, nga të cilat 21 për zonat e prekura nga zjarret dhe 2 për zonat e prekura nga përmytjet në Finiq–Delvinë dhe Novoselë. Produktet përmbajnë evidentimin e zonave të djegura dhe të dëmtuara, klasifikimin e mbulesës së tokës, si dhe krahasimin e imazheve satelitore para dhe pas ngjarjeve.
- Është përfunduar dhe publikuar shtresa “Mbulesa e Tokës” për 61 bashki, nga të cilat 36 janë realizuar gjatë vitit 2025, së bashku me panelin përkatës informues. Gjithashtu, është përfunduar produkti “Mbulesa e Pyjeve” për 61 bashki, nga të cilat 36 janë realizuar gjatë vitit 2025, në funksion të monitorimit të sipërfaqeve pyjore dhe identifikimit të zonave të rrezikuara nga zjarret, prerjet e paligjshme ose degradimi.

- Është përfunduar identifikimi dhe editimi i ndërtesave për 61 bashki, nga të cilat 49 janë realizuar gjatë vitit 2025, në mbështetje të monitorimit dhe menaxhimit të ndërtimeve nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit. Gjithashtu, është realizuar identifikimi dhe editimi i pemëtoreve për 7 bashki.
- Në kuadër të projekteve për mbledhjen e informacionit gjeohapësinor nëpërmjet teknologjisë UAV, gjatë vitit 2025 janë realizuar misione fotografimi në 13 zona, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 135 km². Nga përpunimi i të dhënave janë prodhuar ortofoto me rezolucion shumë të lartë, imazhe oblique, Modele Digjitale të Terrenit dhe të Sipërfaqes, izoipse, të dhëna LiDAR, point cloud dhe modele 3D, në mbështetje të planifikimit, analizës dhe monitorimit të territorit.
- Është realizuar fotografimi panoramik 360° për 16 zona urbane dhe 3 akse të reja rrugore, me një gjatësi faktike të rrjetit të fotografuar prej 1 808.5 km gjatë vitit 2025. Mbulimi i përgjithshëm i realizuar gjatë periudhës 2019–2025 ka arritur në 7 381.5 km. Ka vijuar gjithashtu përpunimi dhe publikimi i panoramave për përdorim në monitorimin e infrastrukturës, planifikimin urban dhe dokumentimin e territorit.
- Është realizuar integrimi i të dhënave të prodhuara nga teknologjia UAV me imazherinë panoramike 360° në platformën ArcGIS Online, duke mundësuar vizualizimin e integruar të ortofotove, modeleve 3D, Modeleve Digjitale të Sipërfaqes dhe panoramave 360°, si dhe navigimin ndërmjet formateve 2D, 3D dhe 360°.
- Janë zhvilluar aplikacione dhe produkte interaktive për evidentimin dhe krahasimin e ndryshimeve territoriale gjatë periudhës 2023–2025 në bashkitë Tiranë, Sarandë dhe Krujë; për evidentimin e ndryshimeve të vijës bregdetare gjatë periudhës 2015–2024; për monitorimin e ndryshimeve të sipërfaqes ujore të Liqenit të Ulzës; si dhe për vlerësimin e cilësisë së trupave ujorë në zonat e mbrojtura, bazuar në indekset e turbulencës, sedimentit pezull dhe klorofilit.
- Janë zhvilluar dhe përditësuar modele të identifikimit automatik për ndërtesat, serrat bujqësore, pyjet dhe pemëtoret, me një saktësi identifikimi rreth 60%. Gjithashtu, janë zhvilluar mjete të automatizuara për përpunimin, kontrollin dhe administrimin e të dhënave, duke përmirësuar efikasitetin dhe standardizimin e proceseve të punës.
- Ka filluar zhvillimi i një modeli të automatizuar për identifikimin e sinjalistikës rrugore nga imazhet panoramike 360°, me qëllim gjenerimin e të dhënave gjeohapësinore të përdorshme në sistemet GIS për monitorimin dhe administrimin e infrastrukturës rrugore.
- Në përgjigje të kërkesave të organeve të drejtësisë, janë përgatitur materiale hartografike për 25 shkresa të ardhura nga gjykatat dhe prokuroritë, duke përdorur imazhe satelitore të viteve 2023, 2024 dhe 2025 për zonat e përcaktuara në kërkesat përkatëse.
- Në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitutional, është realizuar koordinimi formal me Autoritetet Publike Përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet akademike, sektorin privat dhe partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë për nismat dhe projektet në fushën e gjeoinformacionit. Janë përmbushur detyrimet e ASIG-ut si autoritet koordinues i Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor (NSDI), përfshirë raportimet periodike për zbatimin e Direktivës INSPIRE në kuadër të procesit të integritimit evropian. Gjithashtu, janë nënshkruar 6 marrëveshje të reja bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës,

Universitetin Bujqësor të Tiranës, organizatën DigitalDen NGO, Autoritetin e Aviacionit Civil, Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Universitetin Polis.

- Në zbatim të marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve institucionale, kanë vijuar veprimtaritë teknike me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Institutin e Gjeoshkencave, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Hekurudhën Shqiptare, Autoritetin Rrugor Shqiptar, Institutin e Transportit, Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve, Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Albpetrolin, për përmirësimin, popullimin, përditësimin dhe harmonizimin e të dhënave për Sistemin e Adresave, kushtet atmosferike, meteorologjinë, hidrologjinë, rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, transportin rrugor dhe hekurudhor, rrjetin e kanalizimeve, landfillet dhe pusët e naftës.
- Janë realizuar gjithashtu veprimtari teknike me Departamentin e Gjeografisë të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe JICA-n, për përdorimin e produkteve satelitore, monitorimin dhe menaxhimin e pyjeve, interpretimin e indekseve të trupave ujorë dhe zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje. Janë zhvilluar edhe takime teknike me 7 bashki për përdorimin e produkteve 360° dhe realizimin e fotografimeve UAV sipas nevojave konkrete të njësive vendore.
- Në funksion të mbështetjes së autoriteteve publike qendrore dhe vendore, janë përgatitur hartat e stacioneve të plazheve për sezonin veror 2026, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, 11 bashkitë bregdetare dhe liqenore dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; hartat për tokat bujqësore, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; si dhe hartat e zonave me përparësi për zhvillimin e ekonomisë malore, në kuadër të “Paketës së Maleve”.
- Në kuadër të bashkëpunimit me autoritetet hartografike ndërkombëtare, janë përgatitur dhe vendosur në dispozicion të dhënat zyrtare gjeohapësinore për projektet e EuroGeographics: EuroBoundaryMap (EBM), EuroRegionalMap (ERM), OME2 National Large-Scale Data Collection dhe CORDA, në kuadër të “Copernicus Framework Agreement and Associated Annexes”.
- Gjatë vitit 2025 janë miratuar akte të rëndësishme ligjore dhe rregullatore për veprimtarinë e ASIG-ut: VKM nr. 336, datë 19.06.2025, “Për miratimin e listës së të dhënave dhe shërbimeve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor që do të tarifohen, si dhe masën e tarifës”; Urdhri i Kryeministrit nr. 67, datë 30.05.2025, për miratimin e rregullores “Për Metodot e Brendshme të Punës dhe për Sjelljen e Personelit” të ASIG-ut; si dhe Udhëzimi nr. 560/3 prot., datë 28.03.2025, për përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat “Gjeohapësinore” dhe “Mjedisore dhe Vëzhgimit të Tokës”. Është ofruar gjithashtu asistencë ligjore për strukturat e ASIG-ut, përfshirë çështjet që lidhen me procedurat e prokurimit.
- Janë realizuar detyrat e sekretariatit teknik të Bordit për Informacionin Gjeohapësinor, përfshirë përgatitjen e axhendave dhe materialeve, organizimin e infrastrukturës së nevojshme, dokumentimin dhe administrimin e dosjeve për mbledhjet e planifikuara gjatë vitit 2025.
- Janë zbatuar detyrimet që burojnë nga përfaqësimi i ASIG-ut në grupet ndërinstitucionale të punës, si dhe nga legjislacioni për të drejtën e informimit dhe ripërdorimin e informacionit

publik. Në këtë kuadër janë administruar kërkesat në platformën “Pyet Shtetin” dhe është përditësuar Programi i Transparencës.

- Në bashkëpunim me Autoritetet Publike Përgjegjëse dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë identifikuar nevojat për ngritjen e kapaciteteve profesionale. Gjithashtu, është koordinuar puna me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për angazhimin e ekspertëve, përgatitjen e dokumentacionit dhe planifikimin e programeve të trajnimit.
- Janë realizuar 9 trajnime teknike me gjithsej 103 pjesëmarrës. Prej tyre, 6 trajnime institucionale janë zhvilluar me 45 pjesëmarrës nga bashkitë, shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve dhe institucione të tjera publike, ndërsa 3 trajnime ASIG–ASPA janë zhvilluar me 58 pjesëmarrës të certifikuar për modulet “Hyrje në Remote Sensing”, “Aplikimet e Imazherisë Satelitore për Përmirësimin e të Dhënave Gjeohapësinore” dhe “Infrastruktura Kombëtare e të Dhënave dhe Shërbimeve Gjeohapësinore”. Në bashkëpunim me ASPA-n janë hartuar dhe akredituar gjithashtu 3 kurrikula trajnimi.
- Projekti SOFTMOVE, i financuar nga programi Interreg IPA South Adriatic, ka përfunduar më 31.10.2025. Në kuadër të projektit janë realizuar dy workshop-e dhe është dorëzuar Plani i Përbashkët i Veprimit.
- Janë përgatitur dhe dorëzuar 4 aplikime për financim ndërkombëtar: “KYNESIS”, në programin IPA ADRIAN; “FOREST4FUTURE”, në programin IPA CBC Shqipëri–Kosovë, me ASIG-un në rolin e partnerit udhëheqës; “GEOCONNECT”, në programin IPA CBC Shqipëri–Kosovë; dhe “BRACE”, në programin Horizon Europe, me ASIG-un në rolin e drejtuesit të një pakete pune.
- Projekti “Krijimi i Hartës Bazë në Republikën e Shqipërisë” është përfshirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare me statusin “i maturuar”, duke krijuar premisa për sigurimin e financimit dhe vijimin e zbatimit të tij.
- Është realizuar monitorimi i vazhdueshëm i thirrjeve dhe mundësive për financim të publikuara nga SASPAC, AKKSHI, ASPA, EU4Innovation, programet IPA, platforma Europa.eu, Agjencia Evropiane e Hapësirës dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Për secilën mundësi është vlerësuar përputhshmëria me kapacitetet teknike dhe administrative, si dhe me fushën e përgjegjësisë ligjore të ASIG-ut. Gjithashtu, janë ndjekur sesione informuese dhe seminare për hartimin e projekt-ideve, përdorimin e platformave të aplikimit dhe krijimin e konsorciumeve.
- Është finalizuar Raporti i Riskut për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026–2028, i cili trajton rreziqet prioritare dhe masat përkatëse të menaxhimit. Janë hartuar gjithashtu raporte narrative të zgjeruara mbi progresin e projekteve, aplikimeve për financim dhe veprimtarisë në fushën e projekteve.
- Është zbatuar Plani i Komunikimit për promovimin e aktiviteteve, produkteve, trajnimeve dhe bashkëpunimeve të ASIG-ut. Është realizuar mbledhja, redaktimi dhe publikimi sistematik i përmbajtjes institucionale në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale. Është hartuar dhe publikuar dokumenti i arritjeve të ASIG-ut për periudhën 2024–2025, në gjuhën shqipe dhe angleze, në version elektronik dhe të shtypur. Gjithashtu, është administruar komunikimi zyrtar dhe janë përgatitur materiale promovuese, përfshirë broshura, video dhe prezantime.

II. PROBLEMATIKAT E EVIDENTUARA

- *Qëndrueshmëria teknike e Gjeoportalit Kombëtar dhe vonesat në realizimin e projektit “Ndërtimi i Sistemit të GIS-it Kombëtar”*

Pavarësisht se funksionimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e Gjeoportalit Kombëtar janë garantuar nga stafi teknik i ASIG-ut, sistemi vijon të mos mbulohet nga një kontratë aktive mirëmbajtjeje, duke krijuar rrezik për qëndrueshmërinë, sigurinë, përditësimin teknologjik dhe adresimin në kohë të problematikave të tij. Njëkohësisht, gjatë vitit 2025 janë rishikuar specifikimet teknike të projektit “Ndërtimi i Sistemit të GIS-it Kombëtar”, pasi vlera e përlloritur rezultoi më e lartë se buxheti i alokuar. Megjithëse dokumentacioni i rishikuar i është përcjellë AKSHI-t, projekti nuk ka kaluar ende në fazën e zbatimit, duke vonuar modernizimin dhe integrimin e proceseve të GIS-it Kombëtar.

- *Bashkëpunimi ndërinstytucional, kapacitetet teknike dhe dorëzimi i të dhënave gjeohapësinore*

Në disa Autoritete Publike Përgjegjëse dhe njësi të vetëqeverisjes vendore, bashkëpunimi teknik nuk ka qenë i qëndrueshëm, për shkak të mungesës së pikave teknike të kontaktit dhe të burimeve njerëzore të specializuara në fushën e gjeoinformacionit. Kjo situatë ka ndikuar në dorëzimin periodik, përditësimin, përpunimin dhe standardizimin e të dhënave gjeohapësinore. Për këtë arsye, mbetet i nevojshëm forcimi i koordinimit teknik ndërinstytucional dhe vijimi i programeve të trajnimit.

- *Cilësia, përditësimi dhe ndërveprueshmëria e të dhënave gjeohapësinore*

Një pjesë e të dhënave të dorëzuara paraqet mungesë përditësimi, mospërputhje me standardet shtetërore, problematika në saktësinë gjeometrike dhe atributive, si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet sistemeve burimore dhe Gjeoportalit Kombëtar. Këto problematika janë evidentuar veçanërisht në të dhënat kadastrale, të ndërtesave dhe në bazat e të dhënave sektoriale.

- *Nevoja për përditësimin e të dhënave referuese kombëtare*

Harta Bazë, ortoimazheria dhe Modeli Digjital i Terrenit kërkojnë përditësim të vazhdueshëm, pasi përbëjnë bazën referuese për planifikimin, projektimin, kontrollin e territorit dhe vendimmarrjen institucionale. Realizimi i mbulimit kombëtar dhe përditësimi periodik i tyre kërkojnë investime të qëndrueshme dhe financim shumëvjeçar.

- *Kapacitetet e pamjaftueshme të infrastrukturës teknologjike për Remote Sensing*

Për administrimin, përpunimin, analizimin, shpërndarjen dhe ruajtjen e imazheve satelitore, të dhënave UAV, skanimeve LiDAR dhe imazheve 360° nevojiten pajisje harduerike me kapacitet dhe performancë më të lartë, serverë lokalë, hapësira të sigurta ruajtjeje dhe lidhje interneti me shpejtësi të përshtatshme. Kapacitetet aktuale kufizojnë realizimin efikas të përpunimeve të avancuara dhe zbatimin e modeleve Deep Learning.

- *Varësia e produkteve nga licencat dhe infrastruktura cloud*

Ndërprerja e kontratës së projektit “Shërbime Satelitore” ose e licencave përkatëse mund të sjellë paaksesueshmërinë e përkohshme të produkteve të publikuara në ArcGIS Online, përfshirë hartat tematike interaktive, aplikacionet web dhe produktet e shpërndara për institucionet përfituese.

- *Vështirësitë operative në realizimin e fotografimeve UAV dhe 360°*

Proceset e fotografimit në terren janë ndikuar nga kushtet e pafavorshme atmosferike, terreni i vështirë, gjendja e infrastrukturës rrugore, kufizimet e aksesit në prona private dhe mungesa e sinjalit celular në disa zona rurale dhe malore. Këta faktorë kanë shkaktuar vonesa në mbledhjen, transmetimin dhe përpunimin e të dhënave.

III. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

- Garantimi i qëndrueshmërisë teknike dhe funksionale të Gjeoportalit Kombëtar nëpërmjet finalizimit, në bashkëpunim me AKSHI-n, të procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar, konsolidimit të procedurave të monitorimit, backup-it dhe sigurisë së sistemit, si dhe përmirësimit të performancës dhe disponueshmërisë së shërbimeve ekzistuese.
- Nisja e zbatimit të projektit strategjik “GIS Kombëtar”
 - Organizimi dhe realizimi i procedurës së prokurimit nga AKSHI;
 - Fillimi i fazës së implementimit të sistemit;
 - Integrimi gradual i APP-ve në procesin e dorëzimit automatik të të dhënave.
- Përmirësimi i cilësisë dhe përditësimit të të dhënave gjeohapësinore prioritare
 - Intensifikimi i bashkëpunimit me APP-të për temat prioritare (adresat, transporti, kadastra dhe lejet zhvillimore);
 - Ndjekja e projektit “Prodhimi i ortofotove nga fotografimet historike”;
 - Vendosja e cikleve të rregullta të dorëzimit dhe përditësimit;
 - Verifikimi teknik dhe harmonizimi sipas standardeve shtetërore.
- Përditësimi i të dhënave referuese kombëtare
 - Fillimi i zbatimit të projektit të Hartës Bazë Kombëtare (fotografimi ajror);
 - Përditësimi progresiv i ortoimazherisë dhe DTM-së;
 - Harmonizimi me kërkesat e INSPIRE-s.
- Zgjerimi i aksesit publik dhe konsolidimi i të dhënave të hapura
 - Rritja e numrit të shtresave të publikuara nëpërmjet shërbimeve ATOM;
 - Kalimi gradual drejt shërbimeve OGC API;
 - Harmonizimi me kuadrin e High-Value Datasets (HVD).
- Ndjekja e implementimit të projektit “Shërbimi Satelitor” për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë. Krijimi i hartave tematike për produktet e projektit “Shërbimi Satelitor”, në funksion të plotësimit të kërkesave të institucioneve shqiptare sipas zonave të tyre të interesit, nëpërmjet:
 - Hartimit të ortofotove satelitore RGB dhe CIR për vitet 2025 dhe 2026 për territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - Identifikimit dhe monitorimit të serrave bujqësore, ndërtesave, sipërfaqeve pyjore dhe ujore;
 - Krijimit të hartave tematike për mbulesën e tokës, shëndetin e bimësisë, cilësinë e ujit dhe të tokës;
 - Mbulimit të territorit me imazhe satelitore hiperspektrale dhe analizës së tyre.
- Ndjekja e implementimit të fotografimit me kamera “Street View 360°”. Ky proces ka për qëllim krijimin e një baze të detajuar të të dhënave vizuale për rrjetin rrugor dhe zonat urbane, duke mundësuar dokumentimin e gjendjes aktuale të infrastrukturës, ndërtesave dhe elementeve të tjerë me interes publik.

- Ndjekja e implementimit të fotografimit me teknologjinë UAV, për zgjerimin e mbulimit me ortofoto, DTM dhe DSM me rezolucion të lartë në zona urbane, turistike, rurale dhe bujqësore; krijimin e një arkive të përqendruar të ortofotove UAV për përdorim institucional; zhvillimin e modeleve për identifikimin automatik të ndërtesave në ortofoto me rezolucion të lartë; si dhe vijimin e bashkëpunimit ndërsektorial për integrimin e të dhënave të përftuara nga dronët me imazherinë Street View 360°.
- “Gjenerimi i IG-së së duhur”. Implementimi, vënia në përdorim dhe mirëmbajtja e KRGJSH-së. Hartimi i specifikimeve teknike për fazën VI të KRGJSH-së, ndërtimi i rrjetit gravimetrik dhe llogaritja e gjeoidit V. 2026, matja e pikave gjeodezike dhe mareografike, si dhe monitorimi, mirëmbajtja dhe raportimi mbi funksionimin e stacioneve ALBCORS.
- Disponueshmëria e IG-së së duhur. “Ndërtimi i Sistemit të të Dhënave Gjeohapësinore për Zhvillimin e Rajoneve nëpërmjet krijimit të Hartës Bazë të Republikës së Shqipërisë në zonat prioritare”. Rilevimi fotogrametrik 3D në zona urbane dhe rurale, përpunimi dhe verifikimi i të dhënave në terren, strukturimi i bazës së të dhënave hartografike dhe hartimi i standardeve për menaxhimin e saj.
- Dija institucionale dhe kapacitetet njerëzore. Ngritja e kapaciteteve të stafit të ASIG-ut nëpërmjet pjesëmarrjes në organizata dhe veprimtari ndërkombëtare, trajnime, workshop-e, seminare etj.
- Koordinimi strategjik i NSDI-së dhe përafrimi ligjor
 - Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional me autoritetet publike, sektorin akademik dhe atë privat;
 - Finalizimi dhe miratimi i paketës së re ligjore, duke përfshirë vendimin për “Planin e Masave për Qeverisjen e Sektorit 2020–2030” (maj 2026) dhe ndryshimet në VKM-në nr. 451/2019 për rregullat uniforme të infrastrukturës (shtator 2026);
 - Organizimi dhe mbështetja e mbledhjeve të Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG);
 - Përmirësimi i transparencës institucionale dhe raportimi për kapitujt e integritetit evropian.
- Menaxhimi i projekteve dhe thithja e fondeve
 - Koordinimi dhe monitorimi i projekteve strategjike në zbatim;
 - Menaxhimi i aplikimeve dhe pjesëmarrjes në programe dhe projekte ndërkombëtare;
 - Identifikimi i mundësive të reja për financim dhe partneritete;
 - Koordinimi i shërbimeve me pagesë dhe administrimi i proceseve përkatëse;
 - Përgatitja e raporteve të progresit dhe analizave të riskut për portofolin e projekteve, duke vlerësuar efikasitetin operacional.
- Ngritja e kapaciteteve dhe edukimi në gjeoinformacion
 - Vijimi i bashkëpunimit me ASPA-n për zhvillimin e programeve të akredituara në fushën e gjeoinformacionit, duke synuar rritjen e numrit të zyrtarëve të certifikuar;
 - Realizimi i trajnimeve teknike për institucionet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
 - Organizimi i aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjësuese për promovimin e gjeoinformacionit.

- Promovimi institucional dhe komunikimi
 - Publikimi i aktiviteteve, projekteve dhe produkteve të ASIG-ut në kanalet zyrtare të komunikimit;
 - Administrimi i komunikimit institucional me publikun dhe partnerët;
 - Hartimi dhe publikimi i materialeve promovuese, informative dhe vizuale;
 - Rritja e ndërgjegjësimit dhe e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve të ASIG-ut nga institucionet dhe publiku.